Ne zonen e Korces dhe ne luginen e Devollit jane kryer studime per bonifikimin e fushes dhe ndertimin e rjetit drenazhues te fushes se Devollit ne zonen e Bilishtit dhe ne fushen e Korces. Ne kete fushe jane kryer studime per linjen e gazit TAP. Jane kryer studime rajonale per ndertimin e hartes gjeologjike te Shqiperise. Jane kryer studime gjeologjike ne fushen e inxhinierise se ndertimit kur eshte studiuar zona e qytetit te Korces. Jane kryer studime per materialet e ndertimit, qe mund te perdoren per qytetin e Korces.

Ne zonen nga Elbasani deri ne Mollas jane prezente depozitimet terrigjene te Neogjenit dhe depozitimet e Kuaternarit, por ne zonen ku kalon rruga jane prezente depozitimet e meposhtme:

A) Depozitimet e Oligocenit te mesem (Pg_3^2)

B) Depozitimet e Neogjenit Burdigalian (N_1^1b)

C) Depozitimet e Kuaternarit Q_h

A) Depozitimet e Paleogjenit Pg_3^2

Keto depozitime perbehen nga shkembinj flishore (argjilite dhe ranore) me ngjyre te bezhe ne gri jane me çarje me cimentim te dobet deri mesatar. Jane te perajruar formaojne shpate te buta . Nuk rekomandohet te perdoren si materiale ndertimi.

B) Depozitimet e Neogjenit Burdigalianit (N_1^1b)

Jane depozitime te reja qe perbehen nga argjilite alevrolite dhe ranore rralle takohen ndershtresa gelqeroresh. jane me ngjyre kafe te kuqerremte jane me çimentim te mire deri te dobet, pjesa siperfaqesore e tyre eshte e perajruar. Ne pergjithesi formojne shpate te paqendrueshme por ne zonen ku do te ndertohet rruga e re nuk jane prezente keto depozitime ato takohen nenthellesine 50-75m.

C) Depozitimet e kuaternarit.

Sipas menyres se formimit keto depozitime do te ndahen ne depozitime liqenoro kenetore, depozitime aluviale dhe depozitime deluvialo - eluviale.

- *Depozitime aluvialo* perfaqesohen nga suargjila surera rera dhe zhavore jane me ngjyre bezhe ne gri .jane mesatarisht te ngjeshura.Takohen ne shtratin e Lumit Dunavec.

- *Depozitimet liqenore-kenetore* perfaqesohen nga depozitimet e zones se fushes se Korces keto depozitime nderthuren me depozitimet liqenore perfaqesohen nga suargjila argjila lymore surera dhe rera me rralle shtresa torfike. Jane depozitime te pakonsoliduara deri pak te konsoliduara,takohen ne zonen fushore dhe kane trashesi 50-60m

- *Depozitimet deluvialo - eluviale* perfaqesohen nga suargjila, suargjila zhavorore. Jane mesatarisht te konsoliduara. Takohen ne shpatet e kodrave ne pjesen fundore te rruges se re. Ata vendosen mbi formacionet rrenjesore dhe kane trashesi 2.0 – 3.5 metra. Ne disa raste keto depozitime jane te paqendrueshme ato rreshqasin ne drejtim te renies se relievit. Jane prezente ne zonat kodrinore larg aksit te rruges se re.

3.2 Kushtet Hidrogjeologjike

Nga studimet e kryera ne zonen Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë (nga matjet e kryera ne shpimet dhe ne gropat) rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i ndryshem. Autoret e studimit kane shfrytëzuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja ne to jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithë periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte 4.00-5.20m kurse ne zonat kodrinore eshte me larg nga sipërfaqja e tokes .

Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra neutrale,nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

4.0.PUNIMET FUSHORE

Per percaktimin e kushteve te detajuara gjeologjike dhe gjeoteknike te rruges **Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë** ne bashkepunim me grupin e projektimit eshte hartuar nje program i detajuar.

4.1 Qellimi i Punimeve Fushore

Punimet fushore kane per destinacion te percaktojne ne terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike ne zonen ku do te behet ndertimi i rruges se re.Ne fazen e punimeve fushore jane marre dhe kampionet me strukture te prishur dhe te paprishur per tu analizuar ne laborator. Ne fazen e punimeve fushore jane prodhuar hartat gjeologjike te shkalleve te ndryshme. Ne kete faze jane identifikuar dhe fenomenet negative fiziko gjeologjike qe jane prezente ne kete zone.

4.2 Inspektimi i Punimeve ne Terren

Te gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike, shpimet per germimet e medha, per vendet e ndertimit te urave dhe per materialet e ndertimit, gropat per klasifikimin e dherave te bazamentit te rruges se re jane kryer. Mbi bazen e te dhenave te korektuara pershkrim fushor dhe rezultate laboratorike eshte bere perpilimi I raportit gjeologjik.

4.3 Planifikimi i Thellesise se Gropave dhe Shpimeve si dhe Caktimi i Tyre ne Terren

Para fillimit te punes ne terren eshte bere studimi i draftit te projektit te detajuar mbi bazen e te cilit jane projektuar punimet fushore.

a) Per te vleresuar pjesen e re te rruges jane hapur disa shpime me thellesi 5.00m dhe rilevime gjeologjike te detajuara

b) Per te vleresuar kushtet gjeologjike te urave jane te kryer rilevime gjeologjike, jane kryer disa shpime 20.00m.

c) Per vleresimin e materialeve te ndertimit jane marre disa kampione nga karierat ekzistuese dhe ne ato vende ku eshte e mundur te merren materiale ndertimi.

Te gjitha punimet ne fillim do te aprovohen nga grupi i projektimit .

4.4 Gropat

4.4.1 Metoda e germimit

Gropat jane germuar me punetor me madhesi te vogel meqellim qe te mos prishet ambienti ne zonen e banuar nga banoret e zones ne pikat e percaktuar behej germimi gropes, mbasi behej germimi ne faqet e pastra te tij behej pershkrimi shtresave gjeologjike dhe mereshin kampinet per ne laborator. Gropat germohen ne prezence te inxhinierit gjeolog i cili drejtonte manovratorin per menyren e kryerjes se punes.mbasi eshte bere pershkrimi gropat jane mbuluar menjehere dhe jane ngjeshur per te mos krijuar çedime me vone.

4.4.2 Marrja e Kampioneve

Marrja e kampioneve ne gropa eshte kryer si me poshte; mbasi behej germimi I gropes deri ne thellesine 2.00-3.50m dhe identifikohet numri I shtresave qe takohej ne prerjen e gropes merrej kampioni per te matur lageshtine natyrore per secilen shtrese I cili futej ne nje bukse per te ruajtur lageshtine deri ne laborator.Matja e lageshtires eshte bere dhe ne terren me aparaturen e matjes se lageshtires ne terren neqoftese ajo ishte me e vogel se 15%,per rastet e tjera shkonte ne laborator. Sipas rastit qe varej nga numri i shtresave qe takoheshin merrej kampione ne thase plastike me peshe deri 25-30kg. per secilin thes vendosej etiketa me adresen e gropes dhe me thellesine perkatese.Kampioni merrej duke I vecuar ne faqen e pusit shtresat dhe behej germimi I ri per marrjen e kampionit pa u perzier me shtresat e tjera.

4.4.3 Matja e Nivelit te Ujit Nentokesor

Mbasi mbaronte germimi e gropave,pershkrimi I shtresave dhe marrja e kampioneve gropa lihej e hapur per disa ore per te pritur grumbullimin e ujit dhe per te matur nivelin e tij. Nga punimet fushore niveli ujit nentokesor nuk eshte takuar pothuajse ne asnje grope.Nga gropat eshte marre kampioni per vleresimin e perberies kimike te ujrave nentokesore.

4.5 Shpimet me rrotullim

Punimet kryesore qe jane kryer ne studimin gjeoteknik te kesaj rruge jane shpime me rrotullim te cilat jane kryer kryesisht ne vendet ku do te ndertohen urat dhe ne disa vende te tjera te cilat jane quajtur te rendesishme per projektin e rruges.

4.5.1 Pershkrimi i paisjeve te perdorura

Shpimet ne rruget e re do te realizohen me disa paisje shpimi (drill machine) te cilat do ti pershkruajme si me poshte.

4.5.2. Marrja e Kampioneve me Strukture te Prishur dhe te Paprishur

Shpimet jane realizuar me autosonda me menyre shpimi me rrotullim tipi "Craelius".Menyra e shpimit realizohet duke shpuar me nje karotier (core drilling) me diameter $\phi=100\text{mm}$, gjatesi sipas rastit 2.00-3.00m dhe pusi (hole) mbrohet me tub rrethimi

(casing)(tub metalik me diameter $\phi=150\text{mm}$). Mbasi mbarohet nje manover shpimi me karotier,futet nje tub rrethimi,pastrohet pusi deri ne thellesine e shpuar me pare duke treguar vemendje qe struktura e tokes te mos prishet, pastaj sipas programit ekzekutohet nje test ose merret nje kampion me strukture te paprishur (tipi shellby). Gjate gjithë kohes pusi eshte i mbushur deri ne gryke me uje.

Menyra e nxjerrjes se kampionit nga karotieri (core drilling) eshte me preison me nje pompe e cila formon nje perzierje ajer dhe uje. Shtangat e shpimit (rods) jane me gjatesi 1.5-3.00m dhe me peshe 10kg/ml.

a) Marrja e kampioneve.

Ne studimet gjeologjike dhe gjeoteknike prarshikohet te merren disa lloje kompionesh te cilat sherbejne per te identifikuar cilesite e dherave. Te cilat me hollesisht po i trajtojme me poshte.

1. Kampione me strukture te prishur nga Testet (SPT) i cili eshte quajtur D_{spt} Ky lloj kampioni eshte marre ne kete menyre :Sapo mbaron prova SPT hapet core spt dhe behet pershkrimi i kampionit ,pastaj futet ne nje qese plastike dhe mbeshtillet me skoç me qellim qe te ruhet lageshtira natyrore. Keto kampione vlejne per te matur lageshtine dhe per te bere analiza identifikimi.
2. Kampione me strukture te prishur te tipit small disturbed sample qe jane shenuar me "D". Pesha e kampioneve eshte marre sipas tipit te llojit te dherave sasia ne peshe e tyre.Per keto kampione jane zbatuar keto menyra marrje menjehere sapo del kampioni nga core drilling behet pershkrimi i tij dhe futet ne nje qese plastike pastaj mbeshtillet me skoç me qellim qe te ruaje lageshtine natyrore. Te gjitha kampionet ruhen ne arka druri qe te mos demtohen gjate transportimit per ne laborator. Njekohesisht gjate dites ruhen ne vende te freskete qe te mos demtohen nga veprimi e rrezeve te diellit.
3. Kampione bulk disturbed samples sipas tipit te dherave ato jane marre ne keto permasa ;
Per argjilat (clay) ,fin sand and silt jane marre me peshe =3kg
Per medium sand me peshe 5kg. Dhe keto kampione siç e kemi pershkruar me siper menjehere sapo kampioni del nga core drilling behet pershkrimi i tij dhe pastaj futet ne qese plastike behet me skoç dhe pastaj ruhet me kujdes ne arka prej druri.

Kampione me strukture te prishur me pesha 40kg per te kryer testet Proctor and CBR ,keto kampione zakonisht merren ne puse te cekta dhe sherbejne per klasifikimin e shtresave te zonave ku do te ndertoehn rruge she sheshe per parkime te ndryshme.

Kampione me strukture te paprishur ne tubo metalike me diameter $\phi=100 \times 550$ mm dhe $\phi=80 \times 550$ mm. Per te realizuar marrjen e ketyre kampioneve ne fillim jane pregatitur tubo metalike me gjatesi te pergjithshme 600mm dhe gjatesia efektive e tubit me kampion eshte 550mm. Para se te merret kampioni trangu i pusit eshte i pastruar dhe i mbushur deri ne gryke me uje. Mbasi te jete realizuar fundi i pusit i paster me toke natyrore te paprishur futet intrumenti per marrejn e kampionit i cili masi arrin ne ballin e pusit (fundi i tij ose Botom) shtyhet instrumenti pa rrotullim me gjatesine e tubit metalik i cili eshte 600mm dhe menjehere ngrihet intrumenti deri ne siperfaqe per te marre kampionin. Mbasi del kampioni pastrohet tubi metalik dhe pastaj ne te dy anet rreth 20mm mbushen me parafine dhe ne fund behet me skoç gjithe kampioni. Shenohet etiketa e marrjes se kampionit (ose adresa e marrjes se tij) Ne te gjitha rastet matet thellesia e marrjes se kampionit prara dhe mbas ekzekutimit te tij.Keto kampione ruhen me kujdes ne arka druri qe te mos demtohen gjate udhetimit per ne laborator.

5.0 ANALIZAT LABORATORIKE

5.1 Qellimi i provave

Sipas programit te hartuar jane kryer testimet laboratorike te mostrave te marre ne zonen ku kalon segmenti i rruges. Testimet u kryen per te percaktuar karakteristikat fiziko – mekanike te llojeve te dherave dhe te shkembinjve, te cilat jane me strukture te prishur dhe te paprishur. Keto kampione jane marre nga shpimet, gropat ne ketyre segmenteve rrugore.

Provat laboratorike jane kryer duke ndjekur kerkesat e kontraktorit dhe konsulentit, si dhe duke ndjekur procedurat ne fuqi te Manualit te Cilesise te laboratorit.

Keto procedura qe jane konform ISO 9001 – 2008 dhe EN ISO 17025-2006 garantojne cilesine dhe saktesine, si dhe nje raport te plote e te hollesishem te provave te kryera.

Kualifikimi i larte i stafit te laboratorit garanton kryerjen e te gjitha provave gjeoteknike te kerkuara ne kete raport. Drejtuesit e laboratorit vendosin per programin e kryerjes se provave ne perputhje me kerkesat e porositesit dhe konsulentit. Drejtuesit e laboratorit jane pergjegjes per cdo certificate prove te leshuar. Pajisjet dhe instrumentet matese te laboratorit te vlefeshme per keto prova ruhen shume mire, ne menyre qe te garantojne kryerjen e sakte te proves. Cdo pajisje kontrollohet periodikisht sipas procedures se Manualit te Cilesise.

5.2 Percaktimi I struktures se kampionit,ngjyres dhe fortesise

Per klasifikimin e kampioneve te testuara eshte ndjekur nje procedure rigoroze ku cdo kampioni I eshte vendosur nje targe perkatese sipas te ciles identifikohet plotesisht origjina e kampionit, vendmarrja, thellesia dhe te gjitha hollesite e tjera te nevojeshme. Kampionet e mberitura ne laborator jane ruajtur me kujdesin maksimal, ne temperature dhe lageshti ne menyre qe te mos kishte ndryshime te karakteristikeve te tyre origjinale.

Duke zbatuar kerkesat e kontraktorit dhe konsulentit, ne laborator u kryen provat e meposhteme:

- Hapja e kampioneve me strukture te paprishur nga cilindrat metalike me ane te nje hidraulic extruder. Pershkrimi I kampioneve sipas BS 1377-1:1990 3/3.2
- Percaktimi I Lageshires natyrore, duke ndjekur normativen BS 1377-2:1990 3
- Percaktimi I kufinjve te plasticitetit, duke ndjekur normativen BS 1377-2:1990 4.5,5.0 .
- Percaktimi I Peshes Specifike duke ndjekur normativen BS 1377-2:1990 8/8.4
- Percaktimi I Peshes Volumore duke ndjekur normativen BS 1377-2:1990 7
- Percaktimi I analizes granulometrike me sita BS-series, sipas normatives BS 1377-2:1990 9/9.2
- Percaktimi I granulometrise se materialit te imet i cili u krye ne materialin qe kalon siten BS - 0.063mm, sipas normatives BS 1377-2:1990 9/9.5

5.3 Testimet e Dherave

5.3.1 Testimet Standarte

Ne kemi pershkruar me siper menyren e kryerjes se analizave te identifikimit te llojeve te dherave qe kane mbritur ne Laborator si dhe standartet e perdorura. Ne laborator provat jane kryer bazuar ne standardet BS(British Standard ,ASTM, AASHTO, UNI) ne cdo certificate te testeve jane te shenuar dhe standartet e perdorura per realizimin e proves. Paisjet qe disponon laboratory jane te pershtatshme per te kryer testimet sipas standardeve te mesiperme.

5.3.2 Procedurat e Vecanta per Kampionet me Strukture te Paprishur

Kampionet me structure te paprishur jane te ruajtur ne tubo metalike me gjatesi 600mm te cilat nuk lejojne qe te behet ne terren pershkrimi i kampionit qe eshte brenda ne tube, ne terren pershkruhen vetem dy pjeset anesore te tij. Kampioni del nga tubi me anen e hidraulik extruder dhe behet pershkrimi i tij nga inxhinieri i laboratorit pershkruhet lloji i dheut, ngjyra, kompaktesia, dhe struktura. Zgjidhet pjesa qendrore e kampionit per tu analizuar e cila perfaqeson pjesen me te parishur te kampionit dhe sipas rastit sipas programit fillojne testimet, testimet e klasifimit te dherave te cialt i kemi pershkruar me siper metodiken e perdorur. Testimet me te rendesishme per keto tipe kampionesh jane:

- Prova e One-Dimensional consolidation (oedometric test) duke rritur

ngarkesen ne kampionet cilindrike (Diametri = 50.27mm dhe lartesi = 20mm), duke ndjekur proceduren BS 1377-2:1990 .3. Ngarkesat e perdorura zgjidhen ne funksion te thellesise se marrjes se kapionit, ne funksion te ngarkeses qe do te ushtrohet nga objekti qe do te vendoset mbi shtresat gjeologjike nga te cilat eshte marre ky kampion. Nga ky testim vleresohen parametra shume te rendesishme sic jane koha e llogaritjes se uljeve te shtresave mbasi eshte vendosur ngarkesa e objektit qe do te ndertohet. Llogariten dhe madhesia e uljeve . Keto jane parametra shume te rendesishme per objektin qe do te ndertohet, Bazuar ne ambientin gjeologjik qe eshte takuar ne terren kemi parashikuar dhe numrin e provave One-dimensional consolidation.

- Prova e Direct Shear Test consolidated undrained conditions ne kampione katrore me gjeresi & gjatesi 60mm dhe lartesi 20mm, duke ndjekur proceduren BS – 1377-7:1990 4. Keto testime jane shume te rendesishme dhe jane kryer sipas udhezimeve te dhena nga Mr. Charles Scott Dunn specialist me shume ekperisence ne fushen e mekanikes se dherave, per te marre parametra te pa drenuara duke prere sa me shpejt qe te lejon aparatura kompionin ose per te marre parametra te drenuara duhet llogaritet koha e drenimit dhe ne varesi te saj do te pritet kompioni. Keto parametra jane te rendesishme per llogaritjet e themeleve te objekteve.

5.4. Testimet ne Shkembinj

Ne rrugen Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë materiali shkembor eshte testuar me metoda qe ka ne dispozicion laboratory i kompanise. Ne keto shkembinj jane kryer provat e meposhtme:

- Prova e shtypjes njeaksilae per sandstone sipas normatives BS 137 –7:1990 4
- Prova Braziliane test,
- Prova me çekiç,
- Prova pikesore (Point load test).
- Prova e proktorit te modifikuar duke ndjekur normativen AASHTO T – 180/C
- Prova e CBR ne 95% te maksimumit te proktorit duke ndjekur normativen AASHTO T – 193
- Prova e ekuivalentit te reres duke ndjekur normativen UNI 8520/15
- Prova e Los Angeles duke ndjekur normativen UNI 8520/19 e rakorduar me kerkesat e ASTM

6.0 REZULTATET E STUDIMIT NE TERREN DHE NE LABORATOR

Ne kete kapitull do te trajtohen interpretimi i rezultateve te studimit gjeologjik dhe gjeoteknik qe eshte kryer ne kete segment rrugore. ne kete raport do te jepen kushtet gjeologo inxhinierike per gjithë gjatesite e segmentit te rruges.

Ne programin e studimit jane kryer testime ne terren dhe ne laborator per te percaktuar kushtet gjeologjike te aksit te segmentev te rruges ekzistuese per te percaktuar qendrueshmerine e trupit te rruges nga fenomenet negative te aktivitetit koloidal te shtresave argjilore.per te percaktuar qendrueshmerine e skarpatave ne mbushje,per te percaktuar kushtet gjeoteknike te veprave te artit. Per te percaktuar cilesite e materialeve te ndertimit.Rezultatet e ketyre studimeve do ti trajtojme me hollesisht me poshte.

6.1 Kushtet Gjeologjike te segmentit te rruges ekzistuese

Ne kete faze studimi jane kryer punime ne terren shpime dhe gropa ,jane kryer

rilevime gjeologjike te detajuara. jane kryer disa analiza laboratorike.

Nga punimet ne terren kemi vrojtuar ne terren se rruga ekzistuese eshte e shkaterruar asfalti ka krijuar nje rjete merimange carjesh me poshte jane vrojtimet ne terren te ketij aksi rrugor:







Nga punimet e kryers ne rruge rezulton struktura e rruges eshte si me poshte:
0.00-0.04m dhe rralle deri 0.06m asfalt ne gjendje te keqe poroz dhe i oksiduar,
Deri ne thellesine 0.25m dhe ne disa raste 0.43m cakell i perzier me zhavorr eshte i ngjeshur. Nen keto thellesi del toka natyrore e cile perbehet nga materiale suargjilore deri ne surere. Jane pak deri ne mesatarisht te ngjeshura. Treguesi i CBR eshte 2-3%
Niveli i ujit nentokesor ne momentin e kryerjes se punimeve nuk reflekton nivelin maksimal te ujit nentokesor sepse kete viti ka qene nje vit me thatesire, por kur te filloje renia e shirave niveli I ujit nentokesor eshte shume afer siperfaqes se tokes. Meqenese jane dhera argjilore per afekt te levizjes kapilare uji nentokesor ngrihet deri afer siperfaqes se tokes keshtu qe trupi i rruges eshte gjithmone i lagur. Ne periudhat me shume thatesire sidomod ne muajt Gusht dhe Shtator siperfaqja e tokes se zone ku kalon rruga eshte shume e thate dhe per rjedhoje materiali argjilor qe eshte ne themelin e rruges cahet dhe si pasoje dhe objektet qe jane me themele te cekta sic eshte rruga demtohet. Ne kete kushte per te rikonstruktuar kete rruge dhe te kete nje jete te gjate rekomandojme te merren masat e meposhtme:

1. Shtresat ekzistuese te rruges te mos hiqen vetem ne asfalt te krijohet nje siperfaqe e valezuar. Ne cdo 30-40m te ndertohet nje drenazh i cili te mbushet me material drenues.
2. Mbi shtresat ekzistuese te shtrohet material drenues dy shtresa nga 25cm. Te ngjishen mire materiali te jete i thyer jo material nga lumi. Granulometria e materialit te jete e rregullt dhe me madhesi 0.00-70mm. Ngjeshja te jete e mire jo me pak se 98% e ngjeshjes ne laborator.

3. Mbi keto shtresa te vendosen shtresat e mbistrukturese se rruges sipas llogaritjeve te projektuesit duke marre parasysh se ne kete rruge do te kaloje nje trafik shume i rende dhe intensiv.

➤ **Kushtet gjeologjike te zonave ku rruga eshte ne mbushje kur kemi ruge te re**

Ne keto segmente rrugore nuk ka mbushje te medha por ne qoftese do te kete ne rekomandojme:

1. Te pastrohet toka vegjetale te shtrohen nje shtrese gjeotekstili dhe mbi ate te ndertohet mbushja e rruges. Ne dy anet e rruges te ndertohen kanalet anesore te cilat do te siguroje nje trup rruge te drenazhuar.
2. Ne rastet kur relievi ku kalon rruga eshte me pjerresi me shume se 15° rekomandojme a)qe te krijohet nje shkallezim nen trupin e mbushjes. b) te behet drenazhimi i shpatit per te siguruar nje stabilitet te pergjithshem te shpatit dhe pastaj te behet ndetimi i trupit te rruges. Ne ato raste kur lartesia e trupit te rruges eshte mbi 10m rekomandohet te perdoren mbushje te perforcuara.

➤ **Kushtet gjeologjike te rruges ne zonat me germime**

Ne kete segment te rruges Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë nuk ka germime me lartesi te medha por neqoftese do te kete,bazuar ne te dhenat gjeologjike te mara ne terren dhe ne laborator rekomandojme te merren masat e meposhtme:

1. Skarpatat e germimeve per mbulesen aluvialo deluvialo eluviale te jene ne raportet **1 Vertikale dhe 2 Horizontale**
2. Skarpatat e germimit per shkembinjte rrenjesore te jene ne raportet **1 Vertikale dhe 1 Horizontale.**
3. Ne fundin e cdo skarpate te ndertohet nje mur prites me lartesi 1.5-2.00m
4. Mbjellja e pemeve qe thithin lageshtiren si shelgjet dhe akaciet te cilat perforcojne skarpatat me rrenjet e tyre.

6.2 Kushtet gjeologo inxhinierike dhe gjeoteknike te veprave te artit te vogla dhe te medha.

Ne segmentin e rrugor Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë ka disa vepra arti me madhesi te ndryshme sic jane tombino, ura te vogla 5-10m.Bazuar ne te dhenat gjeologjike themelet e urave te vogla jane te cekta dhe ato nuk do te behen te reja por do te riparohen ato ekzistuese. Shtresa e zhavoreve ka karakteristika te mira fiziko mekanike.

6.3 Karakteristikat fiziko mekanike te shtresave gjeologjike qe takohen ne aksin e rruges ekzistuese Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë.

Nga punimet e kryera ne studimin gjeologjik te rruges Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë, bazuar ne perberjen gjeologjike dhe ne karakteritikat fiziko mekanike kemi vecuar shtresat e meposhtme te cilat po i pershkruajme ne vecanti.

SHTRESA Nr.1

Perfaqesohet nga toka vegjetale qe perbehet nga suargjila te mesme me ngjyre kafe ne bezhe me lageshtire plastike permbajne rrenje bimesh dhe guriçka. jane pak te ngjeshura ne cdo rast rekomandohet te hiqet kjo shtrese para se te filloje ndertimi i pjeses se re te rruges kjo shtrese ka trashesi te vogel 50-60cm.

Ne rrugen ekzistuese jane prezente shtresat : 0.00-0.04m dhe rralle deri 0.06m asfalt ne gjendje te keqe poroz dhe i oksiduar, por nga km 5+200 deri ne km 7+800 gjendja e asfaltit eshte e mire. Deri ne thellesine 0.25m dhe ne disa raste 0.43m cakell i perzier me zhavorr eshte i ngjeshur. Nen keto thellesi del toka natyrore e cile perbehet nga materiale suargjilore deri ne surere. Jane pak deri ne mesatarisht te ngjeshura. Treguesi i CBR eshte 2-3%.

SHTRESA Nr.2

Perfaqesohet nga suargjila te mesme me ngjyre kafe ne bezhe me lageshtire dhe ne gjendje plastike. Permbajne guriçka te vogla dhe copa çakelli dhe zhavori, permbajne dhe shtresa te holla rere dhe surere. Jane pak deri ne mesatarisht te ngjeshura. Takohet ne thellesite ;shiko prerjen gjeologo litologjike ne aksin e rruges. Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	32.60 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	44.80 %
Fraksioni rere dhe zhavor	> 0.05 mm	22.60 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{rr} = 42.50 \%$ Kufiri i poshtem i
plasticitetit	$W_p = 21.30 \%$ Numri i plasticitetit
$F = 21.30$	
Lageshtia natyrore	$W_n = 29.60 \%$ Pesha specifike
$\delta = 2.70 \text{ T/m}^3$	
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 1.96 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit	$\varepsilon = 0.70$
Grada e lageshtise	$G = 0.90$
Moduli i deformacionit	$E = 85 \text{ kg/cm}^2$
Koeficienti i ngjeshjes	$\alpha = 0.038 \text{ cm}^2/\text{kg}$
Moduli i uljes	$S = 34.20 \text{ mm/ml}$ Kendi i ferkimit te
brendshem	$\varphi = 18^\circ$ Kohezioni
$C = 0.21 \text{ kg/cm}^2$	
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 1.80 \text{ kg/cm}^2$
Treguesi I CBR	CBR = 2-3%

SHTRESA Nr.3

Perfaqesohet nga zhavor koker trashe deri ne koker mesem jane me ngjyre bezhe ne gri me lageshtire deri te ngopura me uje. Permbjane shtresa te holla

rere dhe surere. Jane mesatarisht te ngjeshura. Takohet ne zonat prane shtratit te lumit Dunavec ne thellesite ;shiko prerjen gjeologo litologjike ne aksin e rruges.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberia granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	6.50 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	6.33 %
Fraksioni	>4.00mm	20.25%
Fraksioni zhavor	> 4.00 mm	66.92 %
Lageshtia natyrore		$W_n = 16.68 \%$
Pesha specifike		$\delta = 2.68 \text{ T/m}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale		$\Delta = 2.06 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit		$\varepsilon = 0.68$
Moduli i deformacionit		$E = 180 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem		$\varphi = 32^\circ$
Kohezioni		$C = 0.03 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje		$\sigma = 2.20 \text{ kg/cm}^2$
Treguesi I CBR		CBR = 25-30%

SHTRESA Nr.4

Perfaqesohet nga suargjila te lehta deri ne surera, jane me ngjyre kafe ne bezhe me lageshtire deri ne plastike. Jane pak deri ne mesatarisht te ngjeshura.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberia granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	34.20 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	54.60 %
Fraksioni rere	> 0.075 mm	8.60 %
Fraksioni zhavor	> 4.00mm	8.60 %
Lageshtia natyrore		$W_n = 33.24 \%$

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{\pi} = 50.65 \%$
Kufiri i poshem i plasticitetit	$W_p = 31.43 \%$
Numri i plasticitetit	$F = 19.22$
Pesha specifike	$\delta = 2.52 \text{ T/m}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 1.77 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit	$\varepsilon = 0.72$
Moduli i deformacionit	$E = 70 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 22^\circ$
Kohezioni	$C = 0.15 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 1.60 \text{ kg/cm}^2$
Treguesi I CBR	CBR = 4-5%

SHTRESA Nr.5

Perfaqesohet nga rera koker vogla deri ne koker mesme. jane me ngjyre kafe jane te ngopura me uje. Permbajne guricka te vogla dhe zaje zhavori. Jane mesatarisht te ngjeshura. Takohen ne thellesite shiko prerjen gjeologo litologjike ne aksin e rruges

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor dhe pluhuror	<0.075 mm	24.90 %
Fraksioni	deri ne 4.00mm	62.70 %
Fraksioni zhavor	> 4.00 mm	12.40%
Lageshtia natyrore		$W_n = 19.50 \%$
Pesha specifike		$\delta = 2.67 \text{ T/m}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale		$\Delta = 1.98 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit		$\varepsilon = 0.68$
Moduli i deformacionit		$E = 140 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem		$\varphi = 30^\circ$
Kohezioni		$C = 0.09 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje		$\sigma = 2.00 \text{ kg/cm}^2$
Treguesi I CBR		CBR = 20-30%

SHTRESA Nr.6

Perfaqesohet nga zhavorre koker mesme deri ne koker vogel, jane me ngjyre bezhe ne gri, jane te ngopura me uje. Permbajne shtresa te holla rere dhe surere. Takohet ne thellesine: shiko prerjen gjeologo litologjike ne aksin e rruges.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor dhe pluhuror	<0.075 mm	19.60 %
Fraksioni	deri ne 4.00mm	28.31 %
Fraksioni zhavor	> 4.00 mm	51.49%
Lageshtia natyrore		$W_n = 13.23 \%$
Pesha specifike		$\delta = 2.68 \text{ T/m}^3$
Pesha volumore ne gjendje natyrale		$\Delta = 2.09 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit		$\varepsilon = 0.64$
Moduli i deformacionit		$E = 380 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem		$\varphi = 34^\circ$
Kohezioni		$C = 0.06 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje		$\sigma = 2.40 \text{ kg/cm}^2$
Treguesi I CBR		CBR = 30-450%

SHTRESA Nr.7

Perfaqesohet nga suargjila te renda deri ne argjila, jane me ngjyre gri ne te kalter me lageshtire plastike. Jane pak deri ne mesatarisht te ngjeshura.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	54.10 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.075 mm	45.30 %
Fraksioni rere	> 0.075 mm	0.60 %
Fraksioni zhavor	> 4.00mm	0.00 %
Lageshtia natyrore		$W_n = 30.52 \%$

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	$W_{rr} = 53.27 \%$
Kufiri i poshem i plasticitetit	$W_p = 30.72 \%$
Numri i plasticitetit	$F = 22.56$
Pesha specifike	$\delta = 2.67 \text{ T/m}^3$

Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\Delta = 1.86 \text{ T/m}^3$
Koeficienti i porozitetit	$\varepsilon = 0.70$
Moduli i deformacionit	$E = 90 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendshem	$\varphi = 19^\circ$
Kohezioni	$C = 0.21 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 1.80 \text{ kg/cm}^2$
Treguesi I CBR	CBR = 2-3%

7.0 MATERIALET E NDERTIMIT

Per ndertimin e rruges jane te domosdoshme materialet qe do te sherbejne per mbushjet e rruges, materialet per prodhime e shtreave granulare,per prodhimin e betoneve dhe te asfalteve. Jane studiuar te dy tippet e materialeve dhe jane vleresuar dhe sasite e tyre.

Ne studimin e karierave jane patur parasysh disa pika te rendesishme si:

1. Qe vendet e tyre te jene sa me prane objektit qe do te ndertohet sic eshte rruga Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë
2. Te shfrytezohen ne maksimum karierat ekzistuese qe jane prane kasaj rruge.
3. Gjate shfrytezimit te karierave te ruhet ambienti nga ndotja dhe te mos prishet peisazhi natyror.
4. Materialet te plotesojne cilesite teknike sipas standartit qe eshte projektuar kjo rruge.
5. Jane bere studime dy kariera shkembore.

Nga studimi gjeologjik i zones ku do te ndertohet rruga e re shkembinjte me karakterisrika me te mira per tu perdorur si materiale ndertimi jane shkembinjte gelqerore,konglomerate dhe ranore.

Per studimin e tyre jane perdorur gropa me thellesi 2m si dhe jane marre materiale direkte ne shkembijte gelqerore qe jane te zbuluar ne siperfaqe,jane kryer ne laborator analizat e domosdoshme per vleresimin e tyre.

7.1 Karierat qe do te perdoren per mbushjet e trupit te rruges.

Zona ku eshte kryer studim eshte shume e varfer me materiale ndertimi. Per mbushjet e ndryshme te trupit te rruges jane studiur materiale qe jane ne kodrat perreth sic jane kodrat e Voskopit dhe te ndonje fshati tjetër qe shfrytezohen tani nga ndermarrja te rrethit Korce sic eshte kariera ne fshtin Lumalas. Keto materiale jane testuar dhe plotesojne kerkesat e projektit per mbushjet e ndryshme qe do te kryhen per ndertimin e kesaj rruge.Ne fazen e ndertimit te rruges eshte e domosdoshme qe materialet e ndertimit te studiohen me hollesisht per karierat qe do te vendose ndermarrja e zbatimit te punimeve gjithmone duke u aprovuar nga supervizori i punimeve.

7.2 Kariera qe do te perdoren per prodhimin e shtresave te mbistruktures se rruge dhe per prodhimin e asfaltit e betoneve te ndryshme.

Per keto tipe materialesh jane studiuar dy kariera qe jane ne Voskopit dhe te Lumalasit sepse keto jane me afer trupit te rruges.Gjithe zona eshte shume e varfer me keto lloje shkembore. Karierat e Voskopit perbehen nga shkembij te forte gelqerore qe plotesojne kushtet per tu perdorur per prodhimin e betoneve dhe te asfalteve.Jane kariera ekzistuese.Por duhet te theksohet qe materiali para se te perdoret duhet te testohet te marre aprovimin e supervizorit te punimeve sepse ndosh qe ne masivin e gelqeroreve te jene prezente shtresa gelqerosh te bute te cilat duhet te eliminohen dhe te mos perdoren per ndertimin e rruges.

8.0 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. Zona ku do te ndertohet rruga e re, eshte me relief fushor dhe Kodrinor.Ajo pershkohet nga nje rjet i dendur kanalesh vaditese dhe kulluese dhe nga lumi Dunavec.
2. Gjate relivimit gjeologjik,dhe punimeve gjeologjike fushore qe jane kryer per studimin gjeologjik dhe gjeoteknik nuk jane konstatuar fenomene te levizjeve massive te masave dherore qe te kercenojne qendrueshmerine e trupit te rruges.
3. Ne zone e studiur takohen depozitimet e Neogjenit dhe te paleogjenit qe perbehen nga argjilite konglomerate dhe ranore, dhe depozitimet karbonatike te Cretakut. Depozitimet e kuateranrit perfaqesohen nga suargjila, argjila lymore, argjilas torfike, surera, rera dhe me rralle zhavore.
4. Problemet kryesore gjeoteknike qe duhen zgjidhur ne kete segment rrugor jane. a) zvogelimi I fenomenit negative te aktivitetit koloidal te argjilave me masat e propozuara ne teks b) permiresimi i themelit te rruges.c)stabilizimi i skarpatave.d) vendosja e themeleve te urave ne thellesine e duhur qe te jene te mbrotura si nga erozioni dhe nga fenomeni i rreshqitjeve me kalimin e kohes f) eliminimin e diferences se uljeve ne kontaktin e trupit te rruges me shpatullat e urave.
5. Materialet e ndertimit per mbushjet e ndryshme jane prane rruges se re ku jane prezente shkembijte gelqerore. Per shtresen e siperme te asfaltit rekomandoj te perdoren inerte nga zona e Vithkuqit qe kane karakteristika te mira fiziko mekanike dha zgjasin shume jeten e rruges.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT**

RAPORTI TOPOGRAFIK
RIKONSTRUKSION RRUGE. UNAZA LUMALAS -
MELÇAN - PORODINË

PERGATITI:

DPKZHT, BASHKIA KORÇË

Korce 2019

Permbajtja:

1. Njohja me terrenin (Rikonjucioni Kodrinor)
2. Stafi, instrumentet topografike dhe software
3. Metodologjia e matjeve (Sistemi kordinativ,rrjeti,matjet dhe perpunimi)
4. Monografia e Pikave te rrjetit (Koordinatat, Foto, Pershkrimi me Vizatim)

1. Njohja me terrenin (Rikonjucioni Kodrinor)

Aksi i rruges Unaza Lumalas - Melçan - Porodinë, nga pikepamja gjeografike , eshte e pozicionuar ne jugelindje te Shqiperise, ne Qarkun e Korces, në territorin administrativ të Bashkisë Korçë, në Njësinë Administrative Bulgarec. Objekti shtrihet në Perëndim të Njësinë Administrative Qendër Bulgarec, dhe kufizohet : në Jug : fshati Turan, në Veri fshati Lumalas, në Lindje rruga nacionale Korçë - Tiranë dhe në Perëndim fshatrat Vinçan e Goskovë e Poshtme. Aksi kalon pergjate rruges egzistuese ne nje zone me relief fushor dhe kondrinor.




Fillimisht u njohem me terrenin duke percaktuar me perafersi vendet ku do te fiksojme pikat e rrjetit poligonal, vrojtuan zonat me problematike me bimesi ose te thepisura, zonat urbane etj. Kjo per te bere nje plan pune se cilat zona do maten me GPS dhe cilat zona do te maten me Stacion Total. Ne vendet me bimesi te larte (mbi 4 m) matjet I kryem me stacion total pasi GPS nuk ka sinjal te mire.

Punuam paralelisht me tre grupe pune. Njeri grup filloi fiksimin dhe ndertimin e pikave poligonale. Nje grup filloi me matjen e pikave dhe grupi tjetër me nivelimin.

Pas perfundimit te ketyre operacioneve filluam rilevimin e aksit me fasho 30 –60 m sipas rastit.

Pikat poligonale u vendosen ne vende te fortate sigurta ne menyre qe pikat e njepasnjeshme te kene fushe-pamje me njera-tjetren. Distana ndermjet tyre eshte 1-2 Kml. Ndertimi i pikave u be duke hapur nje grope 50 cm te thell, duke ngulur nje pikete hekuri me diameter 14 mm ose 16 mm dhe pastaj e mbushim me beton duke lene majen e hekurit 2 cm jashte. Per me qarte e kemi ilustruar ne figuren e meposhteme:



Per lokalizimin e pikave poligonale kemi pergatitur edhe nje File Kmz i cili mund te hapet lehtesisht me aparatet marres satelitore ose edhe me smart phone.

2. Instrumented software

Instrumentet topografik qe kemi perdorur per rilevimin e fashes se kerkuar (30 – 60 ml) jane si me poshte:

- **Trimble R8s (L1,L2) me GPS dhe Glonax 440 kanale.**

Instrumentet janë modelet më të reja të kompanisë Trimble, dhe janë blerë 6 muajt e fundit (Nentor 2016)

- **Total Station Leica 803 (3") me DR 200 ml**
- **Total Station Topcon GPT – 7001**
- **Nivel Leica Sprinter M250 1.0/0.7* mm**

- Pasaporta teknike e Marresit Trimble GPS R8S

GNSS Surveying	Real-Time (RTK/VRS) and Postprocessed
Tracking Technology	Trimble 360
Channels	440
Solution Type	Fixed/Float
UHF Radio	Receive & Transmit
Cellular	Yes1
Bluetooth	Yes
Memory	56 MB
Antenna	Integrated
Web Interface	Yes
Integrated Surveying	Yes
GPS	Yes
GLONASS	Yes
Galileo	Yes
BeiDou	Yes
BeiDou-only RTK/PP	Yes
SBAS	Yes
Battery	Single, removable
Field Solution	Trimble Access (Tablet, TSC3, Slate, or Trimble CU), Trimble DL App (Android Devices)

Positioning Performance

Fast Static

Single Baseline

Horizontal.

5 mm + 1 ppm RM

Vertical.

10 mm + 1 ppm RM

Real Time Kinematic surveying

Single Baseline

Horizontal. 8 mm + 1 ppm RM

Vertical. 15 mm + 1 ppm RM

Network RTK

Horizontal. 8 mm + 0.5 ppm RM

Vertical. 15 mm + 0.5 ppm RM

Initialization time. typically < 8 seconds

Initialization reliability. typically > 99.9%



Leica TCR803 Total Station (te dhenat Teknike)

Rezolucioni: 1"

- Devijimi Standart: 3" (1 mgon)
- Fokusimi: 30X
- Fushe Pamja: 1 degree at 30"
- Distanca minimale e matjes: 1.7 m
- Saktesia: 1"
- Lejon Matjen pa prizem DR-mode.250 m.
- Tastiere Alfa Numerike me 31 karaktere.
- Memorie te brendshme 12,500 Matje

TOPCON GPT6002 Reflectorless Card Total Station (Te dhenat Teknike)

Saktesia e matjes Distances

- o Non-prism mode: (Diffusing Surface)
- o 3 to 25m: $\pm(10\text{mm})$ m.s.e.
- o 25m or more: $\pm(5\text{mm}+2\text{ppmXD}^*)$ m.s.e.
- Prism Mode: $\pm(3\text{mm}+2\text{ppmXD}^*)$ m.s.e.
- Least Count in Measurement
 - o Fine measurement mode: 1mm/0.2mm
 - o Coarse measurement mode: 1mm
 - o Tracking measurement mode: 10mm
 - o Fine measurement mode: 1mm: Approx. 1.2 sec. (Initial 3.0 sec.)
 - o Coarse measurement mode: 0.2mm: Approx. 3.0 sec. (Initial 4.0 sec.) Approx. 0.5 sec. (Initial 2.5 sec.)
- Tracking measurement mode: Approx. 0.3 sec. (Initial 2.5 sec.)
- Atmospheric Correction Range: -999.9ppm to $+999.9\text{ppm}$, in 0.1ppm increments
